

REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA FUSHË-KOSOVË / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
Drejtoria për Administratë dhe Personel
Direkcija za Administraciju i Personal

Nr.Br. 61 dt. 16-05 2013
FUSHË-KOSOVË-KOSOVO POLJE



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO POLJE



STATUTI

I

QENDRËS PËR PUNË SOCIALE

NË FUSHË-KOSOVË

Prill 2013
Fushë-Kosovë

Në bazë të nenit 11, nenit 12, pika 12.2 shkronja (d), nenit 17, shkronja (k) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L - 040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28/2008), nenit 6 dhe 7 të Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare Nr. 02/L - 17, nenit 12, pika 12.1, shkronja (gj), nenit 13, pika 13.6 shkronja (ç) dhe nenit 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës së Fushë-Kosovës, Nr. 98, të datës 17.08.2012, me propozim të Qendrës për Punë Sociale, Kuvendi i Komunës së Fushë-Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30.04.2013 miratoi këtë:

STATUTI

I

QENDRËS PËR PUNË SOCIALE

NË FUSHË - KOSOVË

Neni 1

I. Dispozitat e përgjithshme

1. Me këtë Statut rregullohet emërtimi dhe selia, veprimtaria, statusi juridik, përfaqësimi dhe prezantimi, struktura e Qendrës, udhëheqja dhe trupat e Qendrës, zhvillimi i vazhdueshëm profesional, aktet e përgjithshme, pronësia dhe financimi, transparencja, konfidenca (fshehtësia) profesionale, mbikëqyrja e brendshme dhe dispozitat kalimtare dhe përfundimtare lidhur me ushtrimin e veprimtarisë së përkujdesit social dhe familjar në Qendrën për Punë Sociale (në vazhdim të tekstit: QPS).
2. Themelues i QPS - së është Kuvendi i Komunës së Fushë-Kosovës.

Neni 2

QPS-ja ka statusin e institucionit publik, në cilësi të autoritetit punëdhënës, ku organizohet, ofrohet dhe zbatohet përkujdes social, këshillimet dhe në raste të veçanta, edhe ndihmë materiale për rastet në nevojë sociale, konform legjislacionit në fuqi që ndërlidhet me këtë fushë.

Neni 3

1. QPS - ja ka në dispozicion mjetet dhe pasurinë, të cilat i përkasin Komunës.
2. QPS - ja si institucion publik për mbrojtjen e qytetarëve në nevojë sociale, është përvetësuese e fondit për financim të saj nga Buxheti i Kosovës.

Neni 4

II. Emërtimi dhe selia

1. Emri i institucionit është: Qendra për Punë Sociale në Fushë-Kosovë.

2. QPS-ja e mban emblemën e Komunës së Fushë-Kosovës.
3. Emërtimi i QPS-së duhet të jetë i vendosur në objekt të QPS-së, në të cilin kryhet veprimtaria e përkujdesit social, shkruar në gjuhët zyrtare.
4. Për ndryshimin e emrit dhe të selisë së QPS - së vendos Kuvendi i Komunës së Fushë-Kosovës.

Neni 5

Selia e QPS - së është në Fushë-Kosovë, rruga “ 7 Shtatori” nr. 152.

Neni 6

1. QPS-ja ka vulën e saj, që në qarkullimin juridik paraqitet si: Qendra për Punë Sociale në Komunën e Fushë-Kosovës.
2. Vula e rrumbullakët është me diametër 2.5 cm dhe ka këtë përmbajtje:
 - 2.1 rrethi i parë: Republika e Kosovës;
 - 2.2 rrethi i dytë: Komuna e Fushë-Kosovës;
 - 2.3 rrethi i tretë: Qendra për Punë Sociale ;
 - 2.4 në mes të vulës është emblema.
3. Vula katrore e pranimit dhe e dorëzimit është e madhësisë 6 x 2.5 cm, me përmbajtje:
 - 3.1 Republika e Kosovës;
 - 3.2 Komuna e Fushë-Kosovës;
 - 3.3 Qendra për Punë Sociale;
 - 3.4 numri dhe data e evidencës.
4. Vula duhet të përmbajë emërtimin e institucionit dhe selinë, të shkruar në gjuhët zyrtare.
5. Drejtori vendos për mënyrën e përdorimit dhe autorizimin e personit për përdorim dhe ruajtjen e tyre.

Neni 7

III. Veprimtaria e QPS-së

1. Veprimtaria e QPS-së përfshin ofrimin e përkujdesit dhe mirëqenies sociale për banorët e Komunës, si një veprimtari me interes të veçantë shoqëror, përmes ofrimit dhe zbatimit të konceptit të punës sociale dhe mirëqenies sociale në kuadër të sistemit unik të përkujdesit dhe mirëqenies sociale të Kosovës.
2. Koncepti i përkujdesit social konsiston në atë që banorëve të Komunës t’iu ofrojë dhe zbatoj përkujdes dhe mirëqenie sociale, këshillime gjithëpërfshirëse dhe efikase, të bazuar në të dhëna shoqërore: psikologji, sociologji, drejtësi, pedagogji, përmes caktimit të psikologut, sociologut, pedagogut dhe juristit, të cilët për rastet në nevojë sociale do të jenë të domosdoshme në sistemin e përkujdesit social dhe të mirëqenies sociale dhe, njëherësh pikë referuese për specialistët në përkujdesin dhe mirëqenien sociale.

3. Përkujdesi dhe mirëqenia sociale në QPS sigurohet dhe zbatohet nga punonjësit, të cilët i plotësojnë kriteret e parapara me dispozitat e ligjeve në fuqi që rregullojnë marrëdhënien e punës në Kosovë.
4. Caktimi i punonjësve, detyrat dhe përgjegjësitë e tyre, do të rregullohen me akt të veçantë të Komunës.

Neni 8

1. QPS - ja është përgjegjëse për:
 - 1.1 Ofrimin e drejtpërdrejtë të përkujdesjes sociale, këshillimit dhe në raste të caktuara edhe të ndihmës materiale, për rastet me nevojë sociale brenda territorit të Komunës;
 - 1.2 T'iu përmbahet rregulloreve, udhëzimeve dhe procedurave të përcaktuara me ligj, të lejoj marrjen e përgjegjësisë të drejtpërdrejta nga ana e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale;
 - 1.3 Të pranojë fonde vjetore nga Ministria;
 - 1.4 Të zhvillojë aktivitet me qëllim të sigurimit të fondeve apo ndihmave tjera materiale për organizatat joqeveritare që merren me këto veprimtari.
2. QPS - ja ushtron këto veprimtari:
 - 2.1 Siguron ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare brenda territorit të saj, sipas standardeve të specifikuara nga Ministria e Punës për Mirëqenie Sociale (në vazhdim të tekstit MPMS);
 - 2.2 Ndërmerr hapa për të identifikuar natyrën dhe përmasat e nevojës për shërbime sociale dhe familjare, brenda territorit të Komunës;
 - 2.3 Përgatit planin vjetor të punës për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve sociale dhe familjare;
 - 2.4 Mban shënime e statistika, të cilat paraqesin të dhënat e aktivitetit për përkujdes social dhe familjar;
 - 2.5 Përbush detyrat dhe përgjegjësitë e të punësuarve për përkujdesin social dhe mirëqenien sociale, të përcaktuara me dispozitat ligjore dhe të akteve nënligjore;
 - 2.6 Bashkëpunon ngushtë me Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe Ministrinë e Punës dhe të Mirëqenies Sociale, me qëllim të realizimit të përkujdesjes dhe mirëqenies sociale;
 - 2.7 Ushtron edhe veprimtari të tjera të parapara me vendimet e Kuvendit të Komunës.

Neni 9

IV. Statusi juridik, përfaqësimi dhe prezantimi

1. QPS-ja në Fushë-Kosovë është institucion publik i cili bën pjesë në rrjetin e institucioneve të përkujdesit dhe mirëqenies sociale.
2. QPS - ja kryen dhe ofron shërbime të përkujdesit dhe mirëqenies sociale për banorët e Komunës në nevojë, sipas parimit të përkujdesit dhe mirëqenies sociale, të përcaktuar me dispozitat e këtij Statuti, të Ligjit për Shërbimet Sociale dhe Familjare dhe të akteve nënligjore.
3. Për nënshkrimin e kontratave, me të cilat fitohen, tjetërsohen apo shiten objektet, pajisjet (kapitale) të QPS-së, QPS-ja së pari duhet ta ketë miratimin e themeluesit.

4. Në rast të nënshkrimit të kontratave, nga pika 9.3, QPS - ja paraqitet si subjekt i pavarur juridik, bazuar në Ligjin për Prokurim Publik dhe në aktet nënligjore të cilat i nxjerr Ministria e Financave.
5. Për përgjegjësitë e marra financiare, QPS - ja përgjigjet me tërë pasurinë e saj.
6. Themeluesi i QPS - së përgjigjet për obligimet e tij.
7. Qarkullimi i mjeteve financiare bëhet përmes xhirollogarisë së Komunës apo nënlllogarisë së caktuar për QPS - në.

Neni 10

Drejtori i QPS - së ka të gjitha autorizimet për përfaqësimin juridik dhe afarist brenda veprimtarisë së QPS - së, duke marrë parasysh përkufizimet e këtij Statuti dhe të ligjit.

Neni 11

V. Struktura e institucionit

1. QPS - ja, për ta realizuar funksionin e përkujdesit dhe mirëqenies sociale të banorëve, është organizuar nëpërmjet Sektorëve:
 - 1.1 Sektori Administrativo-financiar,
 - 1.2 Sektori i Asistencës Sociale,
 - 1.3 Sektori Social dhe Familjar.
2. Dispozitat më të hollësishme mbi organizimin e brendshëm të QPS - së, përcaktohen me Rregulloren mbi organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës.
3. QPS - ja zbaton sistemin unik të informimit të përkujdesit dhe mirëqenies sociale, ashtu siç është paraparë me Ligjin për Shërbime Sociale dhe Familjare, Ligjit për Skemën e Ndihmës Sociale dhe aktet nënligjore që rregullojnë këtë lëmi.
4. Sistemin e informimit në QPS për shërbime sociale dhe familjare e përbëjnë:
 - 4.1 Sistemi i evidencave, me të cilin rregullohet baza e të dhënave;
 - 4.2 Sistemi me të cilin rregullohet dërgimi, gjegjësisht grumbullimi i të dhënave, përpunimi dhe publikimi i tyre;
 - 4.3 QPS - ja bën mbledhjen, evidentimin dhe vendosjen e të dhënave statistikore në sistemin e informimit për shërbime sociale në programin kompjuterik të Ministrisë, i cili përmban të dhënat e nevojshme për shfrytëzimin e shërbimeve të përkujdesit dhe mirëqenies sociale;
 - 4.4 QPS - ja pas mbledhjes, evidentimit dhe vendosjes së të dhënave statistikore, është e obliguar që, përmes raporteve periodike dhe formularëve të përcaktuar nga Ministria, t'i dërgojë në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale;
 - 4.5 Secili punonjës në QPS gjatë raportimit, duhet të sigurojë fshehtësinë profesionale, duke mos cenuar të drejtat e shfrytëzuesit, përveç rasteve të rregulluara me ligj.

Neni 12
VI. Udhëheqja dhe trupat e QPS - së
Këshilli i ekspertëve

QPS - ja ka Këshillin e ekspertëve, i cili e drejton aktivitetin e QPS - së, nën udhëheqjen e Drejtorit.

Neni 13

Këshillin e ekspertëve e përbëjnë të punësuarit profesionist në Sektorin për perkujdesje dhe mirëqenie sociale.

Neni 14

1. Këshilli i ekspertëve kryen punët, të cilat parashihen me dispozitat e nenit 7, pika 7.9 të Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare, dhe atë:
 - 1.1 Punën profesionale dhe aktivitete specifike brenda QPS - së, të përcaktuar me ligj dhe rregullore;
 - 1.2 Organizimin e QPS - së;
 - 1.3 Vështirësitë në zgjidhjen e problemeve të ndërlikuara profesionale;
 - 1.4 Ushtrimin e të drejtave dhe aktiviteteve tjera të QPS - së në rastet më të rënda individuale;
 - 1.5 Nevojën për arsimim shtesë profesional dhe
 - 1.6 Çështje të tjera të parapara me ligj dhe këtë Statut.

Neni 15

1. Këshilli i ekspertëve konstaton gjendje faktike familjare, vlerëson rrethanat e rastit dhe i rekomandon Drejtorit marrjen e vendimit që shkon në mbrojtjen dhe interes më të mirë të fëmijës.
2. Këshilli i ekspertëve mban takime të rregullta e për të cilat përgatit procesverbalin i cili shqyrtohet dhe miratohet në takimin e radhës.

Neni 16

1. Drejtori është përgjegjës për ushtrimin e kompetencave të përcaktuara për QPS - në, ai e prezanton dhe e përfaqëson QPS - në.
2. Në mungesë të Drejtorit, QPS - në e udhëheq nëpunësi i autorizuar nga Drejtori i QPS-së

Neni 17

1. QPS - në e udhëheq Drejtori i QPS - së.
2. Drejtorin e QPS - së e cakton Kryetari i Komunës, në pajtim me Ligjin dhe aktet nënligjore që e rregullojnë punësimin në Shërbimin Civil të Kosovës.
3. Drejtor i QPS - së mund të zgjidhet personi i cili i plotëson kushtet e caktuara në nenin 7 të Ligjit për Shërbimet Sociale dhe Familjare dhe duhet të jetë: psikolog, sociolog, jurist, pedagog ose

ndonjë lëmi tjetër që ka të bëjë me shërbimet sociale dhe familjare dhe të ketë 3 vite përvojë pune në lëmin përkatës.

Neni 18

1. Vendimin për shpalljen e konkursit për Drejtor të QPS - së e merr kryetari i Komunës.
2. Kryetari i Komunës autorizon Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale të shpall konkursin për Drejtor të QPS - së.

Neni 19

1. Drejtori i QPS-së është përgjegjës për sigurimin e ligjshmërisë dhe punën profesionale të QPS - së, e cila duhet të organizohet dhe të udhëhiqet në pajtim me dispozitat e këtij Statuti dhe dispozitat ligjore.
2. Drejtori i QPS - së është përgjegjës për përkujdesjen e vazhdueshme dhe efektive të përkujdesit dhe mirëqenies sociale për të gjithë banorët e Komunës së Fushë-Kosovës dhe përgjigjet për detyrat në vijim:
 - 2.1 Në pajtim me politikën e përkujdesit dhe mirëqenies sociale, Ligjin për Shërbimet Sociale dhe Familjare, i propozon Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenies Sociale, planin e punës dhe buxhetin e QPS-së për vitin vijues.
 - 2.2 Në mbikëqyrjen dhe autorizimin e Drejtorit të DSHMS, zbaton buxhetin e QPS-së;
 - 2.3 Zbatimin e planit të burimeve njerëzore;
 - 2.4 Udhëheqjen e përditshme të procesit të punës në QPS-së;
 - 2.5 Zhvillimin e marrëdhënieve të mira me donatorët dhe OJQ-të;
 - 2.6 Zhvillimin e vazhdueshëm profesional dhe trajnimin e personelit të QPS-së;
 - 2.7 Vendosjen e mekanizmave të sigurimit të cilësisë në objekte;
 - 2.8 Dhënien e kontributit për zhvillimin e sistemit të informimit të përkujdesit dhe mirëqenies sociale të QPS - së, sipas standardeve të pranuara dhe sigurimin e mbledhjes së informatave, si dhe avancimin e punës ekipore.
3. Programi i punës së QPS - së realizohet duke u bazuar në politikat zhvillimore të sistemit të përkujdesit dhe mirëqenies sociale të nxjerra nga Ministria.
4. Në programin vjetor të punës duhet të përcaktohen: masat, aktivitetet dhe rezultatet e pritura të kujdesit social dhe familjes në QPS - së:
 - 4.1 Plani vjetor i punës;
 - 4.2 Organizimi dhe udhëheqja;
 - 4.3 Burimet njerëzore;
 - 4.4 Plani financiar;
 - 4.5 Raportet mujore, vjetore të punës dhe raportet financiare;
5. Për kryerjen e punëve të tij, Drejtori i QPS - së i përgjigjet Drejtorit të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Kryetarit të Komunës.

Neni 20

1. Drejtori ka për detyrë që gjatë punës, t'ia tërheq vërejtjen Këshillit të ekspertëve në

vendimet që mund të marrë, siç janë:

- 1.1 Aktet e propozuara, të cilat janë në kundërshtim me ligjet relevante, respektivisht aktet e përgjithshme të QPS - së;
- 1.2 Akti i propozuar, i cili është në kundërshtim me programin e punës së QPS - së;
- 1.3 Akti i propozuar, i cili nuk i kontribuon qëllimit të paraparë.

Neni 21

Trupat e QPS-së

1. Për përmbushjen e detyrave të veçanta, Drejtori i QPS - së formon trupa profesionale pranë QPS-së, siç janë:
 - 1.1 Këshilli profesional,
 - 1.2 Kolegji profesional,
 - 1.3 Komisionin disiplinor i QPS - së

Neni 22

Këshilli profesional

1. Këshilli profesional është trup këshillëdhënës për Drejtorin e QPS-së;
2. Këshilli profesional përbëhet nga shefat e sektorëve;
3. Këshilli profesional nxjerr Rregulloren e punës për punën e Këshillit.

Neni 23

1. Këshilli profesional i QPS - së kryen këto detyra dhe punë:
 - 1.1 Shqyrton dhe vendos për nevojën dhe arsyet profesionale të zbatimit të metodave dhe procedurave;
 - 1.2 I propozon Këshillit të ekspertëve dhe Drejtorit, marrjen e masave profesionale për përmirësimin e organizimit të punës dhe kushteve për zhvillimin e veprimtarisë;
 - 1.3 Propozon strukturën e mbikëqyrjes së brendshme lidhur me punën e punëtorëve socialë, si dhe masat për përmirësimin e punës profesionale;
 - 1.4 Shqyrton nevojën për zhvillim profesional dhe i propozon Drejtorit dërgimin e punëtorëve për ngritje profesionale;
 - 1.5 Shqyrton dhe vendos lidhur me çështjet tjera, të cilat Drejtori ia parashtron Këshillit të ekspertëve.

Neni 24

Kolegjiumi profesional

1. Kolegjiumi profesional themelohet me qëllim të shqyrtimit të çështjeve nga lëmi i punës profesionale të çdo sektor.
2. Kolegjiumin profesional e përbëjnë:
 - 2.1 Drejtori i QPS - së dhe
 - 2.2 Shefat e sektorëve.

3. Kolegjiumi profesional i kryen këto punë:

- 3.1 Shqyrton çështjet lidhur me udhëheqjen e punës profesionale në sektor, merr qëndrim dhe jep propozim lidhur me zgjidhjen e këtyre çështjeve;
- 3.2 Shqyrton dhe përmes shefit të sektorit, i propozon Këshillit të ekspertëve nevojën dhe arsyeshmërinë profesionale të zbatimit të metodave të reja;
- 3.3 I propozon Këshillit të ekspertëve dhe Drejtorit, përmes Shefave të sektorëve, marrjen e masave profesionale për përmirësimin e organizimit të punës dhe kushteve për zhvillimin e veprimtarisë.

Neni 25

Organizimi sindikal

1. Në QPS mund të organizohet Organizata Sindikale, ku punëtorët me anëtarësimin e tyre vullnetar, mund t'i realizojnë të drejtat dhe interesat e veta të garantuara me konventat ndërkombëtare të punës dhe me ligj.
2. Në rast greve të punëtorëve, në QPS - së duhet të sigurohet minimumi i kryerjes së detyrave të punës apo shërbimeve.

Neni 26

VII. Zhvillimi i vazhdueshëm profesional

1. Në kuadër të QPS-së ndërmerren masat për zhvillimin profesional për të gjithë punëtorët social, bazuar në dispozitat e Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare dhe aktet tjera nënligjore që rregullojnë këtë lëmi.
2. Financimi i zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punëtorëve bëhet nga buxheti i QPS - së dhe nga burimet tjera në dispozicion.

Neni 27

VIII. Mbikëqyrja e QPS - së

1. QPS-ja i nënshtrohet mbikëqyrjes ligjore dhe profesionale, që sigurohet përmes organeve të autorizuar në bazë të këtij Statuti dhe dispozitave tjera ligjore.
2. Mbikëqyrjen në QPS-së përveç organit mbikëqyrës komunal e bën edhe Departamenti për Shërbime Sociale dhe Familjare i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.
3. Mbikëqyrja e punës profesionale e QPS-së bëhet sipas Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare, Ligjit për Skemën e Ndihmës Sociale dhe akteve nënligjore .

Neni 28

IX. Aktet e përgjithshme

Aktet e përgjithshme të QPS - së janë: Statuti, Rregulloret, Urdhëresat dhe Vendimet përmes të cilave rregullohen çështjet nga veprimtaria e institucionit.

Neni 29

1. Këshilli i ekspertëve dhe Drejtori propozojnë edhe nxjerrjen e këtyre akteve të përgjithshme të QPS-së:
 - 1.1 Rregulloren mbi organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës;
 - 1.2 Rregulloren për përgjegjësinë disiplinore të punonjësve;
 - 1.3 Rregulloren për sigurinë në punë;
 - 1.4 Rregulloren për mbrojtjen kundër zjarrit;
 - 1.5 Rregulloren për rendin shtëpiak;
 - 1.6 Rregulloren për mbikëqyrjen e brendshme;

Neni 30

X. Pronësia, buxheti dhe financat Pronësia

Pasurinë e QPS-së e përbëjnë të drejtat dhe të mirat materiale që kanë qenë të evidentuara si pronë komunale, të cilat QPS - ja, ka pasur të drejtë t'i ketë në dispozicion më datën e hyrjes në fuqi të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

Neni 31

Buxheti

1. Çështjet buxhetore dhe financiare të QPS - së, administrohen në mënyrë transparente, në pajtim me rregulloret dhe procedurat për përdorimin e fondeve nga Buxheti i Kosovë.
2. Buxheti dhe llogaritë e QPS-së duhet t'i përfshijnë të gjitha shpenzimet operative të saja.
3. Prokurimi për QPS-së bëhet konform rregullave të Ligjit të Prokurimit Publik të Kosovës.
4. QPS-ja ia prezanton buxhetin vjetor Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale për miratim në Kuvendin e Komunës.
5. Me pëlqimin e Drejtorit të DSHMS, Drejtori i QPS-së mund të kërkojë revizion të jashtëm, që të monitorojë shfrytëzimin e drejtë të mjeteve.

Neni 32

Financimi

QPS-ja shfrytëzon burimet financiare, në përputhje me Ligjin për Shërbimet Sociale dhe Familje në Kosovë, nga buxheti i Kosovës dhe burimet tjera të parapara me ligjet përkatëse.

Neni 33

XI. Transparenca në punë

Struktura, kushtet dhe mënyra e ofrimit të shërbimeve të përkujdesit dhe mirëqenies sociale, si dhe kryerja e veprimtarisë së QPS-së, janë publike dhe transparente ndaj personave juridikë dhe fizikë, përveç kur bëhet fjalë për sekret afarist dhe profesional.

Neni 34

Informatat dhe të dhënat mbi veprimtarinë, si dhe shikimi në dokumentacionin mbi veprimtarinë e përkujdesit dhe mirëqenies sociale, personave të autorizuar apo mjeteve të informimit, mund t'i jep vetëm Drejtori ose i punësuar i QPS-së, të cilin ai e autorizon.

Neni 35

XII. Konfidenca profesionale Sekreti afarist dhe profesional

Zbulimi i sekretit afarist konsiderohet dhënia e dokumentacionit dhe të dhënave të tjera në shikim të personave të paautorizuar, veprim i cili do t'i shkaktonte dëm imazhit dhe interesit të QPS-së.

Neni 36

1. Sekret afarist konsiderohen:
 - 1.1 Dokumentet të cilat drejtori i vlerëson si sekret afarist bazuar në ligjet në fuqi;
 - 1.2 Të dhënat të cilat organi kompetent i konsideron sekrete dhe ia ofron institucionit si të tilla;
 - 1.3 Masat dhe mënyra e veprimit në raste të krijimit të situatave të jashtëzakonshme;
 - 1.4 Dokumentacionin që përmban planin e mbrojtjes fiziko - teknike të punonjësve dhe pasurisë së institucionit dhe
 - 1.5 Të dhënat tjera, publikimi i të cilave do të ishte në kundërshtim me interesat e institucionit dhe themeluesit të tij.

Neni 37

1. Mosruajtja e sekretit afarist konsiderohet shkelje e rëndë e detyrave të punës.
2. Për ruajtjen e sekretit afarist drejtpërdrejt kujdeset Drejtori.

Neni 38

XIII Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

Në rast se ekziston konflikt midis dispozitave të këtij Statuti dhe dispozitave të Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare, Ligjit për Skemën e Ndihmës Sociale dhe dispozitave të akteve në fuqi që e rregullojnë këtë lëmi atëherë përparësi për zbatim kanë dispozitat e këtyre ligjeve.

Neni 39

Me hyrjen në fuqi të këtij statuti, në afat prej 120 ditëve duhet të nxirren aktet e përgjithësime të Qendrës për Punë Sociale.

Neni 40

U miratua nga Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më datë 30.04.2013.
Ky Statut hyn në fuqi 15 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Fushë-Kosovës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Jakup Tërnavaj

